



Pranuar / Doretuar Priljeno / Profitato Received / Delivered	09 - 02 2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtesa Priloge Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHACK	1658 / 2023		115



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1206/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1206/2022 të datës 16.12.2022 të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë fshat _____ Rr. _____, Komuna e Malishevës, kundër organit të punësimit/Komuna e Malishevës, në çështjen juridike "*masë disiplinore*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datën 09.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1206/2022 e datës 16.12.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Shfuqizohet Vendimi me numër Nr.01/1179 i datës 15.12.2021 i Kryetarit të Komunës së Malishevës për formimin e Komisionit Disiplinor si dhe Vendimi me numër Nr.01/1884 i datës 16.11.2022 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Malishevës lidhur me shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankuesit dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë i cili e ka nxjerr aktin administrativ.

III. Obligohet Kryetari i Komunës së Malishevës, për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesin _____, i punësuar në Komunën e Malishevës sipas Akt emërimit me numër Nr.01/178 të datës 24.01.2012, në pozitën "Zyrtar i Urbanizmit" në Drejtorinë e Urbanizmit, Komisioni Disiplinor në Komunën e Malishevës me datën 16.11.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.01/1884 sipas të cilit i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndalim të pagës prej 40% bruto, për një periudhë prej gjashtë (6) muaj", pas pranimit të Vendimit me numër A.nr.749/2022 të datës 28.10.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me rishqyrtimin e rastit të ankuesit.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin Nr.01/1884 të datës 16.11.2022 të Komisionit Disiplinor në Komunën e Malishevës, me datën 16.12.2022 ka parashtruar ankesën me numër protokolli 8159/2022 të regjistruar nën shenjën A.nr.1206/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të shkeljeve procedurale, vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, i njëjti po ashtu pretendon se përbërja e komisionit disiplinor është në kundërshtim me nenin 49 të Ligjit për Zyrtarët Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 22.12.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Komuna e Malishevës, ndërsa kjo e fundit me datën 13.01.2023, ka dërguar përgjigjen në ankesën e ankuesit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Me datën 27.01.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK/2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit Driton Krasniqi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 8159/2022 të regjistruar nën shenjën A.nr.1206/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e ankuesit të datës 31.08.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.01/1189 të datës 27.07.2022 të Komisionit Disiplinor; Procesverbalin e datës 06.07.2022 të Komisionit Disiplinor; Raportin mjekësor të datës 24.02.2022; Vërejtjen me shkrim me numër Nr.05/149 të datës 29.04.2022; Raportin mjekësor të datës 29.04.2022; Vërejtjen me shkrim me numër Nr.05/201 të datës 30.05.2022; Shkresën zyrtare me numër Nr.04/209 të datës 31.05.2022; Vërejtjen me shkrim me numër Nr.05/229 të datës 30.05.2022; Vërejtjen me shkrim me numër Nr.05/229 të datës 10.06.2022, Raportin mjekësor të datës 10.06.2022; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore me numër Nr.05/303 të datës 14.06.2022; Vërtetimin me numër Nr.01/1979 të datës 05.12.2022; Vendimin me numër Nr.01/1884 të datës 16.11.2022 të Komisionit Disiplinor; Formularët e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 28.12.2018 dhe 09.06.2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 22.12.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 13.01.2022 nga Komuna e Malishevës së bashku me shkresat e

E
UR
MI
P
P

bashkangjitura në lëndë; Aktvendimin me numër Nr.01/1025 të datës 11.07.2018; Akt emërimin me numër Nr.01/178 të datës 24.01.2012 të ankuesit; Vendimin me numër Nr.01/1179 të datës 14.12.2021; Akt emërimin me numër Nr.01/321 të datës 10.03.2017 për ; Akt emërimin me numër Nr.01/266 të datës 02.02.2012 për Akt emërimin me numër Nr.01/1132 të datës 01.08.2018 për F.SH; Procesverbalin e datës 11.11.2022 të Komisionit Disiplinor; Evidencën e hyrje daljeve nga sistemi elektronik për periudhën mars-qershor lidhur me prezencën në punë të ankuesit si dhe Vendimin me numër /2023 të datës 27.01.2023 lidhur me shtyrjen e afatit të ankesës së ankuesit në Këshill.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë i cili e ka nxjerr aktin administrativ, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka analizuar shkresat e lëndës ndërlidhur me rastin e ankuesit, fillimisht ka shqyrtuar pretendimin ankimor të tij lidhur me atë se përbërja e komisionit disiplinor në Komunën e Malishevës nuk është në pajtim me nenin 49 të Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe ndërlidhur me këtë situatë ka konstatuar se, Vendimi Nr.01/1179 i datës 15.12.2021 mbi formimin e Komisionit Disiplinor në Komunën e Malishevës i nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Malishevës, është në kundërshtim me nenin 49 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06 Nr.06/114 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se: "1. Në çdo institucion, në fushën e veprimit të këtij ligji, themelohet një komision disiplinor me mandat 3 vjeçar, që përfshin së paku një përfaqësues të njësisë përgjegjëse" si dhe në kundërshtim edhe me nenin 10 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, në të cilin përcaktohet se: "2. Komisioni disiplinor përbëhet nga tre (3) anëtarë të cilët duhet të jenë nëpunës civilë, nga të cilët njëri duhet të jetë jurist dhe ka këtë përbërje: 2.1. Nëpunës civil i nivelit drejtues - Kryesues i Komisionit; 2.2. Nëpunës civil i nivelit profesional - anëtar dhe 2.3. Nëpunës civil i njësisë së burimeve njerëzore - anëtar, ngase i njëjti komision sipas provave në shkresat e lëndës rezulton se është i formuar nga tre (anëtar) në përbërje të: si kryesues i cili sipas Akt emërimit me numër Nr.01/1132 të datës 01.08.2018, mban pozitën e punës si Udhëheqës i sektorit të shërbimeve publike në Drejtorinë e shërbimeve publike të Komunës së Malishevës, si anëtare e këtij komisioni e cila sipas Akt emërimit me numër Nr.01/321 të datës 10.03.2017 mban pozitën e punës si Zyrtare e lartë për buxhet dhe financa në Drejtorinë për ekonomi, financa dhe buxhet në Komunën e Malishevës si dhe H.XH si anëtar i këtij komisioni i cili sipas Akt emërimit me numër Nr.01/266 të datës 02.02.2023 mban pozitën e punës si Udhëheqës i sektorit për shëndetësi në Drejtorinë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale në Komunën e Malishevës, prandaj Kolegji vlerëson se meqenëse në përbërje të komisionit disiplinor nuk ka anëtar nga njësia përgjegjëse konkretisht nga zyra e burimeve njerëzore të Komunës së Malishevës, i njëjti është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi konkretisht me dispozitat e Ligjit Nr.06 Nr.06/114 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë si dhe bazuar në këtë konstatim si më lartë i njëjti është në kundërshtim edhe me nenin 52 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 dhe 1.5 Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe si i tillë nuk mund të prodhojë efekt juridik dhe mbi këtë

bazë edhe pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me përbërjen e Komisionit Disiplinor të Komunës së Malishevës është i bazuar dhe i drejtë.

Kolegji i Këshillit po ashtu gjatë shqyrtimit të Vendimit me numër Nr.01/1179 të datës 15.12.2021, i nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Malishevës për themelimin e Komisionit Disiplinor, ka konstatuar se tek anëtarët e komisionit është përshkruar vetëm "kryesues dhe anëtarët", ndërsa nuk janë përshkruar pozitat e kryesuesit dhe anëtarëve të këtij komisioni sipas dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë konkretisht nenit 49 paragrafit 5, i cili ka përcaktuar se Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton rregullat e hollësishme për themelimin, përbërjen, përzgjedhjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor, ndërsa me Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë janë miratuar rregullat e hollësishme për këtë fushë, ku neni 10 ka përcaktuar mënyrën e themelimit të Komisionit Disiplinor. Bazuar në nenin 10 paragrafin 2 përcaktohet që: *"Komisioni disiplinor përbëhet nga tre (3) anëtarë të cilët duhet të jenë nëpunës civilë, nga të cilët njëri duhet të jetë jurist dhe ka këtë përbërje: Nëpunës civil i nivelit drejtues –Kryesues i Komisionit; Nëpunës civil i nivelit profesional – anëtar dhe Nëpunës civil i njësisë së burimeve njerëzore – anëtar"*. Meqenëse kjo dispozitë ka përcaktuar që duhet të përshkruhen edhe pozitat e kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit Disiplinor, Kolegji vlerëson se me Vendimin Nr.01/1179 ë datës 15.12.2021, Komuna e Malishevës nuk ka bërë një përshkrim të tillë dhe rrjedhimisht edhe fryma e normës nuk është zbatuar si tërësi.

Si rrjedhojë Kolegji i Këshillit pas vlerësimit të ligjshmërisë së Vendimit me numër Nr.01/1179 të datës 15.12.2021 bazuar në konstatimet e mësipërme, konstaton fillimisht se Kryetari i Komunës së Malishevës është i obliguar të ndërmarrë veprime ligjore lidhur me formimin e komisionit disiplinor në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit Nr.06 Nr.06/114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, e pastaj Komisioni Disiplinor në Komunën e Malishevës për rastin konkret të ankuesit, mbi bazën e fakteve dhe provave të vendos në mënyrë të drejtë dhe ligjore duke marrë parasysh rrethanat nëpër të cilat ka kaluar kjo procedurë.

Ndërlidhur me çështjen konkrete të ankuesit, Kolegji i Këshillit përmes Vendimit me numër A.nr.749/2022 të datës 28.10.2022, kishte vendosur për shfuqizimin e Vendimit Nr.01/1189 të datës 27.07.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Malishevës, vetëm sa i përket shqiptimit të masave disiplinore ndaj ankuesit për: *ndalimin e pagës prej 40% të pagës bruto, për një periudhë prej gjashtë (6) muajsh si dhe ndalimin e ngritjes në detyrë prej dy (2) viteve*, ndërsa i njëjti nuk është lëshuar në konstatimin e gjendjes faktike lidhur me themelimin e komisionit disiplinor meqë nuk ka vendosur meritorisht për ankesën e ankuesit.

Kështu që, duke qenë se Vendimi i atakuar me numër Nr.01/1179 i datës 15.12.2021, i Kryetarit të Komunës së Malishevës lidhur me formimin e Komisionit Disiplinor në këtë institucion, përmban të meta të tilla të cilat pamundësojnë vendosjen meritorie lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit vlerësoi se nuk është lëshuar në trajtimin e ankesës së ankuesit dhe ka vendosur që kjo çështje ankimore të kthehet në ri-shqyrtim dhe

rivendosje tek organi kompetent, në këtë rast tek Komisioni Disiplinor i Komunës së Malishevës, me detyrimin që i njëjti pas nxjerrjes së vendimit të ri lidhur me formimin e Komisionit Disiplinor nga ana e Kryetarit të Komunës së Malishevës vendos për rastin e ankuesit në pajtim me legjislacionin në fuqi, duke marrë parasysh pikëpamjet juridike të dhëna nga Kolegji i Këshillit.

Kështu që pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.1206/2022, datë 09.02.2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Malishevës;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve në Komunën e Malishevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.